



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, datë _____.____.2026

“PËR

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË
TRAJTIMIT EKONOMIK DHE FINANCIAR TË FAMILJARËVE TË
PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT QË HUMBIN JETËN PËR
SHKAK TË DETYRËS, DHE PUNONJËSVE QË PLAGOSEN DHE
DËMTOHEN GJATË OSE PËR SHKAK TË DETYRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 108, të pikës 2, të nenit 111, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme për trajtimin financiar dhe ekonomik të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit, që humbin jetën për shkak të detyrës, punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës, trajtimi mjekësor i punonjësve dhe familjarëve të tyre, si dhe pagesën për shpenzime varrimi të punonjësve të Policisë së Shtetit.
2. Qëllimi i këtij vendimi është përfitimi nga ana e familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit, që humbin jetën për shkak të detyrës, të:
 - a) ndihmës të menjëhershme financiare;
 - b) pensionit familjar suplementar;
 - c) rimbursimit të bursës së studimit në institucionet e arsimit publik për fëmijët e punonjësit;
 - ç) banesës falas për bashkëshorten/in dhe fëmijët kur janë të pastrehë;
 - d) ndihmë financiare për çdo përvjetor vdekjeje;

- dh) organizimit dhe mbulimit të shpenzimeve të ceremonisë mortore;
- e) punësimit me prioritet në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kriteret të tjera të nevojshme për vendin e punës.

3. Kur subjektet përfituese përfitojnë edhe nga akte të tjera ligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë, kanë të drejtë të zgjedhin trajtimin më të favorshëm.
4. Në kuptim të këtij vendimi, me familjarë të punonjësve të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, do të kuptojmë personat sipas përbërjes së certifikatës familjare të punonjësit të Policisë së Shtetit, në momentin e humbjes së jetës për shkak të detyrës.

II. NDIHMA E MENJËHERSHME FINANCIARE

1. Pjesëtarët e familjes së punonjësit Policisë së Shtetit (bashkëshorti/ja, fëmijët, prindërit), që jetonin me punonjësin e policisë në kohën e humbjes së jetës, për shkak të detyrës, përfitojnë deri në 10 (dhjetë) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesë për natyrë të veçantë pune, referuar pagës mujore të muajit të fundit.
2. Kërkesa për trajtim me ndihmë të menjëhershme mund të paraqitet nga secili anëtar madhor i familjes.
3. Për t'u trajtuar me ndihmën e menjëhershme financiare, strukturat e burimeve njerëzore në njësitë shpenzuese, paraqesin për shqyrtim në komisionin përkatës, të ngritur me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) procesverbalin e referimit nga strukturat përkatëse të rrethanave të ngjarjes, në të cilën humbi jetën punonjësi;
 - b) certifikatën familjare;
 - c) certifikatën e vdekjes së punonjësit të policisë;
 - ç) dokument identifikimi për personin që kërkon përfitimin e trajtimit financiar të menjëhershëm;
 - d) një deklaratë të familjarëve madhorë të punonjësit të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, ku shprehin dakordësinë që pagesa të bëhet në emër të kërkuesit, për llogari të të gjithë familjarëve;

- dh) vendimin apo vërtetimin, ku organi i drejtësisë të shprehet për shkakun e humbjes së jetës;
 - e) vërtetimin e llogarisë bankare ku do të kreditohen fondet e ndihmës së menjëhershme.
4. Ndihma e menjëhershme financiare, miratohet me urdhër të ministrit të Brendshëm dhe përballohet nga buxheti i njësisë shpenzuese përkatëse.

III. ORGANIZIMI I CEREMONISË MORTORE

1. Ceremonia mortore organizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
2. Pas vërtetimit të faktit të ndarjes nga jeta të punonjësit të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kujdeset për të siguruar një ceremoni solemne dhe të denjë.
3. Planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve lidhur me ceremoninë mortore bëhet në bashkëpunim me një pjesëtar të familjes, kur kjo kërkohet nga pjesëtarët e familjes.
4. Shpenzimet e varrimit vërtetohen sipas dokumentacionit si më poshtë:
 - a) kërkesë për miratim të shpenzimeve;
 - b) fatura tatimore të shpenzimeve për organizimin e ceremonisë mortore;
 - c) urdhri për pagesën e shpenzimeve të ceremonisë mortore.
5. Shpenzimet e shërbimit të varrimit miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe përballohen nga buxheti i njësisë shpenzuese, sipas dokumentacionit përkatës.

IV. TRAJTIMI FINANCIAR NË DITËN PËRKUJTIMORE

1. Pjesëtarët e familjes së punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, si dhe fëmijët e tij të mitur në çdo rast, çdo përvjetor, përfitojnë ndihmë financiare në masën e një page mujore referuese, e njësuar si pagë mujore, në kohën e dhënies së kësaj pagese.

2. Përfitojnë ndihmën financiare sipas pikës 1 të këtij Kreu, familjarët e punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, që janë akoma në përbërje të së njëjtës certifikatë familjare, si dhe fëmijët e tij të mitur në çdo rast.
3. Paga mujore referuese e punonjësit të policisë përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune që kishte punonjësi, e cila njehsohet si pagë mujore, në kohën e dhënies së kësaj pagese.
4. Për t'u trajtuar me ndihmë financiare, për çdo përvjetor vdekjeje, pjesëtarët e familjes paraqesin një kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke e shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) kërkesë për përfitimin e ndihmës financiare;
 - b) certifikatë familjare e ditës së humbjes së jetës së punonjësit të Policisë së Shtetit;
 - c) certifikatë familjare aktuale;
 - ç) dokumentin që vërteton lidhjen prindërore me të rënin, për fëmijët e mitur që nuk janë në certifikatë familjare;
 - d) dokumentacion identifikimi për personin që kërkon përfitimin.
5. Dhënia e ndihmës financiare miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe përballohet nga buxheti i miratuar i njërive shpenzuese përkatëse në Policinë e Shtetit.

V. PENSIONI FAMILJAR SUPLEMENTAR

1. Pjesëtarët e familjes së punonjësit të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, përfitojnë pension suplementar familjar sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

VI. TRAJTIMI ME BURSË PËR SHKOLLIM

1. Fëmijët e punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë humbur jetën për shkak të detyrës përfitojnë trajtimin me bursa për shkollim në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë, sipas përcaktimeve dhe procedurave për dhënien e tyre në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë.

VII. TRAJTIMI ME BANESË FALAS I FAMILJARËVE

1. Bashkëshorti/ja dhe fëmijët e punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, kur janë të pastrehë, përfitojnë falas:
 - a) të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave ose Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, ose në administrim të tyre;
 - b) banesa të siguruar në zbatim të projekteve të investimit të Korporatës së Investimeve Shqiptare, për të cilat me vendim të Këshillit të Ministrave, vihet në dispozicion pasuri e paluajtshme shtetërore në administrim/pronësi të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë apo entiteteve të tjera publike dhe autorizohet Korporata për shkëmbimin/kompensimin/transferimin e pjesës takuese të saj për realizimin e qëllimit / nevojës publike;
 - c) të sekestruara ose me prejardhje nga pasuri të sekuestruara sipas legjislacionit për sekuestrimin e pasurive nga krimi i organizuar ose të konfiskuara nga ndërtimet pa leje ose në tejkalim të lejes së ndërtimit;
 - ç) të blera sipas çmimit të tregut nga Policia e Shtetit, nga buxheti i miratuar i Policisë së Shtetit.
2. Banesa transferohet pa kundërshtim, në bashkëpronësi të familjarëve të punonjësit të policisë. Pronësia nuk mund të transferohet nga përfituesit sipas formave të parashikuara në Kodin Civil në periudhën që familja përfituese ka fëmijë minorenë, dhe në çdo rast jo më herët se 5 vjet nga marrja në pronësi. Kontrata e kalimit të pronësisë lidhet nga enti administrues i pasurisë sipas vendimit të komisionit në Policinë e Shtetit.
3. Kërkesa për të përfituar banesën falas paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga personi madhor që ka të drejtën e përfitimit, dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) dokumentacion identifikimi për personin/personat që kërkon/jnë përfitimin e banesës falas;
 - b) certifikata familjare;
 - c) certifikata e vdekjes së punonjësit;

- c) vendimin përfundimtar nga institucionet e drejtësisë ku provohet humbja e jetës për shkak të detyrës dhe nëse nuk ka një vendim përfundimtar, procesverbalin e referimit nga strukturat përkatëse të rrethanave të ngjarjes, në të cilën humbi jetën punonjësi;
- d) vërtetim historik nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës që nuk ka banesë në pronësi, në proces regjistrimi apo legalizimi, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për secilin person që ka të drejtën e përfitimit, për të gjithë personat në përbërje të certifikatës familjare të tij, dhe se nuk ka pasur banesë kur ka humbur jetën punonjësi i policisë;
- dh) vërtetim që nuk është aktualisht përfitues nga programet e strehimit social.

4. Për shqyrtimin e kërkesës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ngrihet një komision, i cili kryesohet nga Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Komisioni merr vendim për pranimin ose jo të kërkesës, brenda 1 (muaji) nga momenti i paraqitjes së dokumentacionit të plotë. Komisioni nëse e konstaton të nevojshme, i kërkon kërkuarës plotësimin e dokumentacionit dhe sqarime mbi dokumentacionin e paraqitur. Në çdo rast vendimmarrja bëhet e arsyetuar.
5. Në vendim, komisioni përcakton personat që përfitojnë banesën, vendndodhjen e banesës dhe sipërfaqen sipas aneksit 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Vendimi i Komisionit i përcillet Entit Kombëtar të Banesave, Korporatës së Investimeve Shqiptare, Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Komisionit të Objekteve të Konfiskuara dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, për të vënë në dispozicion banesat e disponueshme që mund të përdoren për trajtimin e familjarëve. Rregullat dhe kushtet e bashkëpunimit midis Komisionit dhe autoriteteve publike të cituara në mënyrë sipër parashikohen në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë dhe drejtuesit të institucionit.
7. Me përcjelljen e vendimit të Komisionit për Korporatën e Investimeve shqiptare, Ministria propozon pronën e paluajtshme shtetërore që vihet në dispozicion të projekteve të investimit të Korporatës në kushtet e legjislacionit të zbatueshëm për veprimtarinë e saj. Në vendimin e transferimit të pronës shtetërore në pronësi / autorizim zhvillimi të KISH përcaktohen kushtet dhe rregullat e sigurimit të njësive të banimit të nevojshme për plotësimin e nevojës publike për llogari të

partnerit publik, me zhvillim të posaçëm apo konvertim/shkëmbim/ transferim të pjesës takuese të palës publike në një projekt investimi të KISH, të përlllogaritur bazuar në çmimin e referencës shtetërore sipas funksioneve përkatëse të kësaj pjese, me njësitë e banimit të nevojshme për plotësimin e nevojës publike, çmimi i të cilave përlllogaritet sa vlera e çmimit të referencës së zonës së vendndodhjes së njësive të banimit plus 3%.

8. Pas vlerësimit të dokumentacionit sipas këtij Kreu, Komisioni vendos banesën që përfitojnë familjarët e punonjësit të policisë. Në rast të përgjigjes negative apo pamundësisë së disponimit të banesave nga entitet e tjera, Policia e Shtetit blen banesë në tregun e lirë bazuar në sipërfaqen që përfitojnë familjarët dhe nënshkruan kontratën e kalimit të pronësisë.
9. Pranë Entit Kombëtar të Banesave krijohet një fond i posaçëm banesash, i cili financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme, me destinacion strehimin falas të bashkëshortit/es dhe fëmijëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë humbur jetën për shkak të detyrës.
10. EKB është përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen dhe regjistrimin e banesave në regjistrin e pasurive të paluajtshme, duke siguruar që ato të mos përdoren për asnjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar në këtë vendim.
11. Kontrata nënshkruhet nga përfituesit me entin pronar ose administrator të banesës që i transferohet në pronësi sipas këtij kreu, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
12. Përfituesit e banesës janë të detyruar të përballojnë vetë shpenzimet e përditshme të përdorimit të banesës, duke përfshirë energjinë elektrike, ujin, ngrohjen, si dhe çdo shpenzim tjetër mirëmbajtjeje që lidhet me përdorimin normal të saj.
13. Në lidhje me kompensimin për shpenzimet e bëra që kanë shtuar vlerën e banesës, zbatohen dispozitat e Kodit Civil.
14. Bashkëshortit dhe fëmijëve të punonjësit të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, deri në përfitimin falas të strehimit, i'u kompensohet qiraja e banesës, sipas vlerës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, që përcakton vlerën minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave.

VIII. PUNËSIMI

1. Ministria e Punëve të Brendshme, brenda limitit organik, trajton me prioritet kërkesën për punësim brenda sistemit të ministrisë, të pjesëtarit të familjes të punonjësit të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kriteret e tjera të përcaktuara për vendin e punës.
2. Pjesëtari i familjes që kërkon të punësohet, dorëzon kërkesën pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke specifikuar vendin e punës për të cilin shpreh interesin, duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin shoqërues për të vërtetuar përvojën dhe kriteret e tjera të nevojshme për vendin e punës.
3. Kërkesat për punësim prioritar sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, administrohen nga struktura e burimeve njerëzore e ministrisë, e cila verifikon plotësimin e kriterit të përvojës dhe kriterëve të tjera të nevojshme, si dhe i kërkon kërkuarit të plotësojë dokumentacionin provues për kriteret, brenda një afati të arsyeshëm.
4. Në rastet kur ministria është në pamundësi për të sistemuar me punë familjarin e punonjësit të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, në vendin e kërkuar prej tij, ose në kërkesën për punësim prioritar nuk ka shprehje interesi për një vend pune të caktuar, kërkesa, e shoqëruar detyrimisht me jetëshkrimin e kërkuarit, i përcillet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
5. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive trajton me prioritet kërkesën për punësim të pjesëtarit të familjes të punonjësit të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kriteret e tjera të përcaktuara për vendin e punës.
6. Në rast të ekzistencës së vendit vakant në përputhje me arsimimin dhe përvojën e kërkuarit, ose krijimit të tij në një moment të mëvonshëm, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive bën lidhjen e kandidatit me punëdhënësin e mundshëm, duke e prezantuar si kategori prioritare për punësim.
7. Punëdhënësi i mundshëm, verifikon plotësimin e kriterit të përvojës dhe kriterëve të tjera të nevojshme, si dhe i kërkon kërkuarit të plotësojë dokumentacionin

provues për kriteret, brenda një afati të arsyeshëm. Në përfundim të procedurës së rekrutimit njofton Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

IX. KOMPESIMI NË RASTET E PLAGOSJES DHE DËMTIMIT TË SHËNDETIT TË PUNONJËSVE TË POLICISË GJATË OSE PËR SHKAK TË DETYRËS

1. Punonjësi i policisë që plagoset apo dëmtohet gjatë apo për shkak të detyrës përfiton deri në 8 (tetë) paga mujore për të dëmtuarit rëndë dhe deri në 4 (katër) paga mujore për të plagosurit dhe dëmtuarit lehtë, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesë për natyrë të veçantë pune, referuar pagës mujore të muajit të fundit.
2. Për të përfituar këtë trajtim financiar, strukturat e burimeve njerëzore në njësitë shpenzuese, paraqesin për shqyrtim në komisionin përkatës, të ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) procesverbalin e referimit nga strukturat përkatëse të rrethanave të ngjarjes;
 - b) vendimin apo vërtetimin, ku organi i drejtësisë të shprehet për shkakun e plagosjes apo dëmtimit të shëndetit;
 - c) aktin që kategorizon plagosjen, si të lehtë apo të rëndë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore;
 - ç) certifikatën familjare;
 - d) dokumentin e identitetit të personit që kërkon përfitimin.

X. TRAJTIMI MJEKËSOR

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit dhe pjesëtarët e familjeve të tyre kur janë të sëmurë dhe trajtohen nga institucionet mjekësore shtetërore brenda vendit, përfitojnë shërbim mjekësor pa pagesë.
2. Këtë të drejtë e përfitojnë edhe në rastet kur diagnostikimi apo mjekimi i tyre kryhet nga institucionet shëndetësore jashtë shtetit.
3. Të drejtën e përcaktimit për diagnostikimin dhe kurimin jashtë shtetit të personelit të Policisë së Shtetit dhe të pjesëtarëve të familjes e ka Komisioni

Ndërspitalor i Ministrisë së Shëndetësisë, i ngritur pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

4. Për kurim jashtë shtetit kërkohet të plotësohet dokumentacioni mjekësor:
 - a) vendim i Komisionit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”;
 - b) epikriza;
 - c) vërtetim i strukturës përkatëse në Policinë e Shtetit, që vërteton punësimin e punonjësit të policisë në këto struktura;
 - ç) fotokopje e letërnjoftimit elektronik;
 - d) certifikatë familjare.
5. Të sëmurët që dërgohen për trajtim shëndetësor për trajtim shëndetësor jashtë shtetit mund të shoqërohen nga personel mjekësor në përshtatje me gjendjen shëndetësore të tyre dhe për rastet kur është e nevojshme edhe nga një pjesëtar madhor i familjes, jo mjekësor, e argumentuar me shkrim nga Qendra e Profilaksisë dhe e Mjekimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
6. Të gjitha shpenzimet për viza, udhëtim, diagnostifikim, mjekim, analiza, etj., që kryhen në spitale përballohen nga Buxheti i Shtetit. Masa e këtyre shpenzimeve miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Shëndetësisë.

XI. PAGESA PËR SHPENZIME VARRIMI

1. Pjesëtarëve të familjes së punonjësit të policisë aktivë, me pagesë kalimtare, në pension pleqërie dhe studentë kursantë, u sigurohet pagesa për përballimin e shpenzimeve të varrimit:
 - a) gjashtë paga referuese mujore të muajit të fundit për ish-punonjësit aktivë të Policisë së Shtetit;
 - b) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të Policisë për ish- punonjësit me pagesë kalimtare;
 - c) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të policisë për ish-pensionistët, për burrat me vjetërsi shërbimi jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe për gratë jo më pak se dymbëdhjetë vjet;
 - ç) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të policisë për ish-studentin;

- d) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të Policisë për ish-kursantët.

XII. TRAJTIMI FINANCIAR PËR PERIUDHËN NGA VITI 1990 DERI 31.12.1998

1. Pjesëtarëve të familjes, që kanë bashkëjetuar me punonjësin e policisë që ka humbur jetën për shkak të detyrës, për periudhën nga viti 1990 deri 31.12.1998, u jepet ndihmë financiare, në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë, çdo pjesëtar.
2. Njësitë shpenzuese, ku ka humbur jetën punonjësi i policisë për shkak të detyrës, për dhënien e ndihmës financiare, plotëson dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) vendimi apo vërtetimi, ku organi i drejtësisë shprehet për shkakun e humbjes së jetës apo akti i shpalljes “Dëshmor i Atdheut”;
 - b) certifikatë e gjendjes familjare në datën e ndodhjes së ngjarjes;
 - c) certifikatë vdekjeje e punonjësit;
 - ç) dokumenti i identitetit të personit që përfiton ndihmë financiare.

XIII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi planifikohen dhe përballohen nga buxheti i miratuar për programin buxhetor “Policia e Shtetit” për vitin përkatës.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, sipas pikës 1, të kreut V, planifikohen dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, sipas Kreut XII, planifikohen dhe përballohen nga buxheti i miratuar për programin buxhetor “Policia e Shtetit”, për vitin 2026.
4. Vendimi nr. 552, datë 27.11.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë që humbin jetën ose plagosen për shkak të detyrës”, vendimi nr. 563, datë 13.10.2001 “Për dhënie ndihme të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit”, Udhëzimi i Përbashkët nr. 1192, dt. 08.03.2000 i Ministrisë së Shëndetësisë,

Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Rendit Publik, “Për kriteret e mënyrat e trajtimit ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë që humbin jetën ose plagosen në krye të detyrës”, si dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Enti Kombëtar i Banesave, Korporata e Investimeve Shqiptare, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

ALBANA KOÇIU

ANEKSI 1

SIPËRFAQJA E BANESËS QË PËRFITOHET NGA FAMILJARËT

Tipi i njësisë së banimit	Numri i anëtarëve të familjes përfituese	Sipërfaqe neto në metër katror
Studio	1	70
1+1	1-2	90
2+1	3-4	130
3+1	4-6	160